

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**L I G J**

**Nr.9723, datë 3.5.2007  
I NDRYSHUAR**

**PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT**

(Ndryshuar me Ligj, Nr.131/2015, datë 26.11.2015, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.205, datë 1 dhjetor 2015).

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**K R E U I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Objekti i ligjit**

Ky ligj rregullon mënyrën e administrimit të regjistrimit tregtar, përcakton subjektet që regjistrohen dhe procedurat e regjistrimit.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.131/2015, datë 26.11.2015, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.205, datë 1 dhjetor 2015).

**Neni 2**

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e tregtisë.
2. “Ministri” është ministri që mbulon çështjet e tregtisë.
3. “Regjistri” është regjistri tregtar, në të cilin regjistrohen subjektet, sipas këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

4. “Regjistrim fillestar” është regjistrimi për herë të parë në regjistër.
5. “Regjistrim tjetër” është çdo ndryshim, shtesë apo fshirje të dhënash në regjistër.
6. “Regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri.
7. “Të dhëna” janë faktet, aktet dhe informacionet që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistër.
8. “Të dhënat e identifikimit për personin juridik” janë forma, emri, numri e vendi i regjistrimit dhe selia.
9. “Dokumentet shoqëruese” janë dokumente, të cilat provojnë të dhënat që regjistrohen.
10. “Aplikim” është kërkesa që i drejtohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për kryerjen e veprimeve në regjistër, sipas këtij ligji.
11. “Aplikant” është subjekti, të cilit i përkasin të dhënat që regjistrohen, njoftohen ose depozitohen në regjistër, apo personat e tjerë që, sipas këtij ligji, kanë të drejtë të kërkojnë kryerjen e veprimeve në regjistër
12. “Subjekt” janë subjektet tregtare dhe subjektet e tjera, të cilat, pa pasur cilësinë e tregtarit, kanë detyrimin e regjistrimit, sipas këtij ligji.
13. “Subjekt” është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja.
14. “Mjet elektronik” është çdo mjet, me anë të të cilit mundësohen dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella apo të marra përmes kablllove, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike.
15. “Sporteli elektronik” është portali elektronik i QKB-së, i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, e hapur nga QKB-ja, ku mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror të QKB-së, nëpërmjet mjeteve elektronike.
16. “Veprimtari” është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet..

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## KREU II

### KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

(Shfuqizohet në tërësinë e tij)

(Ndryshuar me Ligj, Nr.131/2015, datë 26.11.2015, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.205, datë 1 dhjetor 2015).

## KREU III

### REGJISTRI TREGTAR

#### SEKSIONI I

## **REGJISTRI TREGTAR DHE EFEKTET E REGJISTRIMIT DHE TË PUBLIKIMIT**

### **Neni 18**

#### **Përcaktimi i regjistrit tregtar**

1. Regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Regjistri mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas këtij ligji do të regjistrohen nga QKB-ja në format elektronik në dosjen e subjektit në regjister. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese:

a) të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, ruhen dhe arkivohen nga QKB-ja vetëm në format elektronik;

b) të paraqitura në format shkresor, sipas këtij ligji, konvertohen dhe ruhen nga QKB-ja në format elektronik. QKB-ja nuk ka detyrim të mbajë e të arkivojë aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

### **Neni 19**

#### **Të dhënat që regjistrohen**

Regjistri duhet të përmbajë të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.

### **Neni 20**

#### **Mënyra e regjistrimit**

1. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.

2. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton formularët e aplikimit, përmbajtjen e rubrikave të tyre dhe listën e dokumenteve shoqëruese për çdo regjistrim, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

( Pika 3 shfuqizohet.)

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## Neni 21

### Efektet e regjistrimit dhe të publikimit

1. Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundrejtohet të tretëve nga dita e publikimit, sipas nenit 61 të këtij ligji.

2. Në çdo rast, të tretëve nuk mund t'u kundrejtohen të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në regjistrin tregtar, për transaksione të kryera me subjektin brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e publikimit, kur i treti provon se e kishte të pamundur të merrte dijeni, duke treguar të gjithë kujdesin e zakonshëm.

3. Subjekti nuk mund t'u kundrejtojë të tretëve të dhëna, që janë regjistruar dhe/ose publikuar në mënyrë të pasaktë në regjistrin tregtar. Gjithsesi, i treti mund t'i kundrejtojë subjektit të dhënat e regjistruara e të publikuara, edhe nëse këto të dhëna janë të pasakta, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për pasaktësinë e të dhënave të publikuara ose për të dhëna të tjera të papublikuara.

4. I treti mund t'i kundrejtojë subjektit të dhëna ende të papublikuara kur, pavarësisht mospublikimit, i treti kishte dijeni për këto të dhëna, me përjashtim të rastit kur, sipas ligjit, mospublikimi nuk sjell pasoja.

5. Regjistrimet e regjistrin tregtar vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar për autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## SEKSIONI II

### DETYRIMI PËR REGJISTRIM, RREGULLAT E EMËRIMIT, PERSONAT E AUTORIZUAR DHE FORMA E AKTEVE SHOQËRUESE

## Neni 22 Detyrimi për regjistrim

1. Subjektet që detyrohen të regjistrohen janë:

- a) subjektet;
- b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;
- c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;
- ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;
- d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;
- dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së.

2. Përveçse kur një ligj i posaçëm parashikon ndryshe, nuk detyrohen të regjistrohen në regjistër personat fizikë, në kuptimin e Kodit Civil, të përcaktuar me urdhër të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Financave vepronjë si punëdhënës apo të vetëpunësuar në fusha të posaçme apo që ushtrojnë një veprimtari me vëllim të vogël qarkullimi.

3. Subjektet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, aplikojnë për regjistrim fillestar si më poshtë:

a) personat fizikë, shoqëritë e thjeshta dhe degët apo zyrat e përfaqësimit, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë;

b) personat juridikë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, por, në çdo rast, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë.

4. Aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë bëhen brenda 30 ditëve kalendarike nga data e vendimit përkatës, por, në çdo rast, përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

5. Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e hartimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

### **Neni 23**

#### **Rregullat e emërimit**

1. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar i subjekteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat urdhëruese të ligjit.

2. Regjistrimi i emrit kryhet në bazë të parimit të përparësisë së paraqitjes së aplikimit.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare.

4. Emri i subjekteve regjistrohet së bashku me shtojcat që kërkohen, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

### **Neni 24**

#### **Rezervimi i emrit**

1. Çdo individ, duke paguar tarifën përkatëse, ka të drejtë të rezervojë pranë regjistrin tregtar, për llogari të tij apo të të tretëve, një apo më shumë emra të caktuar për regjistrimin.

2. QKB-ja lëshon një certifikatë për rezervimin e emrit brenda një dite nga dorëzimi i aplikimit.

3. Nuk mund të rezervohen emra, të cilët vijjnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 23 të këtij ligji.

4. Rezervimi i emrit, gjatë afatit të vlefshmërisë së parashikuar në këtë ligj, pengon të tretët të rezervojnë emra të njëjtë ose të ngjashëm, apo të regjistrojnë subjekte me të njëjtin emër ose emra të ngjashëm.

5. Rezervimi i emrit është i vlefshëm për një afat prej 30 ditësh, duke nisur nga data e rezervimit. Afati i rezervimit të emrit nuk mund të zgjatet. Rezervimi rishtazi nga i

njëti person i të njëjtit emër të rezervuar më parë vlerësohet si rezervim i ri dhe kryhet sipas rregullave të përgjithshme për rezervimin e emrit, të parashikuar sipas këtij ligji.

6. Verifikimi paraprak nëse një emër mund të regjistrohet ose jo, si dhe rezervimi paraprak i emrit nuk përbën kusht për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e emrit të regjistruar.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## Neni 25

### Transferimi i emrit të rezervuar

Gjatë afatit të vlefshmërisë, emri i rezervuar mund t'u transferohet lirisht të tretëve, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, nëpërmjet depozitimit pranë QKB-së të formularit përkatës. Në këtë rast, QKB-ja bën shënimin përkatës në certifikatën për rezervimin e emrit.

## Neni 26

### Personat e autorizuar për të bërë regjistrimin

1. Aplikimi për regjistrim fillestar dhe regjistrimet e tjera të personave fizikë bëhet nga vetë personi që regjistrohet apo nga çdo person i autorizuar prej tij.

2. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta bëhet nga të gjithë anëtarët apo nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.

3. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit apo nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortakut apo aksioneri, të cilit këto i përkasin.

4. Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja bëhet nga përfaqësuesi ligjor i degës apo zyrës së përfaqësimit, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së huaj apo nga çdo person i autorizuar nga njëri prej personave të përmendur më sipër.

5. Aplikimi për regjistrimin fillestar e regjistrimet e tjera të shoqërive dhe unioneve të kursim-kredive bëhet nga kryetari i bordit drejtues apo nga çdo person i autorizuar prej tij.

6. Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të shoqërive të ndihmës e bashkëpunimit të ndërsjellë bëhet nga kryetari i këshillit administrativ ose nga çdo person i autorizuar prej tij.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

7. Për subjektet e tjera që kanë detyrimin e regjistrimit, sipas shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, aplikimi për regjistrim fillestar bëhet nga

personat e përcaktuar,në përputhje me ligjet përkatëse, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.  
(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

8. Janë të autorizuar të aplikojnë për regjistrim personat e tjerë, që u njihet kjo e drejtë me ligj të veçantë.

## **Neni 27**

### **Aplikimi dhe forma e dokumenteve shoqëruese**

1. Regjistrimi kryhet me dorëzimin e aplikimit përkatës, të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen.

2. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësuar me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji. Dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen edhe në format elektronik, sipas parashikimeve të kreut VI. Dorëzimi i dokumentit shoqërues pranë sporteve të shërbimit në kopje të panjësuar apo në format elektronik bëhet nën përgjegjësinë e plotë të personit që e paraqet atë, i cili, nëpërmjet aktit të dorëzimit, konfirmon njësinë e kopjes apo të dokumentit në format elektronik me origjinalin.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

3.Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

4. Në rast mospërputhjeje të dokumentit shoqërues në gjuhën shqipe me atë në gjuhë të huaj, ky i fundit nuk mund t'u kundrejtohet palëve të treta. Gjithsesi, palët e treta mund t'i kundrejtojnë subjektit të dhënat e përmbajtura në dokumentin në gjuhë të huaj, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për përmbajtjen e dokumentit në gjuhën shqipe.

## **SEKSIONI III**

### **REGJISTRIMI FILLESTAR**

## **Neni 28**

### **Mënyra e aplikimit për regjistrimin fillestar**



1. Personat fizikë regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, si dhe një kopje të dokumentit të identifikimit.

2. Shoqëritë e thjeshta regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, sipas këtij ligji, kontratën përkatëse, sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe kopje të dokumenteve të identifikimit të anëtarëve. Në rast se palët nuk kanë lidhur kontratë me shkrim, regjistrimi i shoqërisë së thjeshtë mund të kryhet duke depozituar vetëm aplikimin, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, kopje të dokumenteve të identifikimit dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë së thjeshtë.

3. Shoqëritë tregtare regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen, gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortakët, anëtarët ose nga personat e autorizuar të veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

5. Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji si dhe:

a) aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme;

b) dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj;

c) dokumentacionin, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;

ç) bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;

d) vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit. Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi, që kërkon regjistrimin, është njëkohësisht organi përgjegjës për të vepruar i vetëm, në emër të shoqërisë së huaj.

6. Shoqëritë dhe unionet e kursim-kredisë, si dhe shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë regjistrohen duke depozituar në regjistrin tregtar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, si dhe çdo dokument tjetër, të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.



## **Neni 29**

### **Subjektet e huaja**

Në rastet e regjistrimit të personave juridikë ose shoqërive të thjeshta me ortak, aksioner ose anëtar një person juridik të huaj, përveç dokumenteve të kërkuara sipas llojit të subjektit, aplikimit për regjistrim fillestar i bashkëngjiten edhe dokumentet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 5 të nenit 28 të këtij ligji, për personin juridik të huaj.

## **Neni 30**

### **Të dhënat e detyrueshme për personat fizikë**

Për regjistrimin fillestar të personave fizikë janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) të dhënat e identifikimit;
- b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
- c) fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- ç) specimeni i nënshkrimit (firmës) të personit fizik.

## **Neni 31**

### **Të dhënat e detyrueshme për shoqëritë e thjeshta**

Për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- b) fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- c) vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
- ç) të dhënat e identifikimit të anëtarëve;
- d) vlera dhe lloji i kontributeve të anëtarëve;
- dh) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;

e) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

## **Neni 32**

### **Të dhënat e detyrueshme për shoqëritë tregtare**

Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) emri;
- b) forma;
- c) data e themelimit;
- ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- d) selia;
- dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
- e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si

dhe afatet e emërimit të tyre.

f) specimentet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

### **Neni 33**

#### **Të dhënat shtesë për shoqëritë kolektive**

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë kolektive, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i llojit e vlerës së kontributeve të të gjithë ortakëve, si dhe pjesëmarrja e tyre në kapital.

### **Neni 34**

#### **Të dhënat shtesë për shoqëritë komandite**

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë komandite, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, është i detyrueshëm njoftimi i shumës ose vlerës së kontributeve të të gjithë ortakëve, pjesa në këtë shumë ose në këtë vlerë e çdo ortaku, “të pakufizuar” ose “të kufizuar”, si dhe pjesa e përgjithshme e ortakëve “të pakufizuar” dhe pjesa e çdo ortaku “të kufizuar”, në shpërndarjen e fitimeve dhe në shumën që mbetet pas likuidimit të shoqërisë.

### **Neni 35**

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përveç sa parashikohet në nenin 32, të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së përgjithshme të kapitalit të nënshkruar, ndarja e kapitalit në një numër kuotash të barabartë me numrin e ortakëve, vlera dhe lloji i kontributit të secilit ortak, pjesa që kuota e secilit ortak zë në kapital, si dhe informacioni nëse kontributet e nënshkruara të kapitalit janë paguar ose jo.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

### **Neni 36**

#### **Të dhënat shtesë për shoqëritë aksionare**

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, janë të detyrueshme edhe këto të dhëna:

- a) vlera e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe pjesa e paguar;
- b) numri dhe forma e aksioneve të nënshkruara;
- c) vlera nominale e secilit aksioner;
- ç) numri i aksioneve të nënshkruara nga secili aksioner;
- d) vlera dhe lloji i kontributit të secilit aksioner, si dhe pjesa e paguar prej secilit;
- dh) kushtet e veçanta, që kufizojnë transferimin e aksioneve (nëse ka);
- e) nëse ka kategori të ndryshme aksionesh, njoftohen të dhënat e shkronjave “c” e “dh” të këtij neni për secilën kategori aksionesh, si dhe të drejtat që lidhen me to;
- ë) procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut;
- f) vlera totale ose një parashikim i kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë për procedurat e themelimit;

g) përparësitë që u njihen personave, që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta, që lidhen me fillimin e veprimtarisë ekonomike (nëse ka);

gj) të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre;

h) numri i anëtarëve të organeve drejtuese;

i) procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse ndryshojnë nga parashikimet ligjore.

2. Shoqëritë aksionare me ofertë publike, përpara regjistrimit fillestar, duhet të regjistrojnë edhe të dhënat e identifikimit të themeluesve, projektstatutin, si dhe të kryejnë njoftimet e mëpasshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore.

3. Të dhënat e përcaktuara në shkronjat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “i” të pikës 1 të këtij neni mund të njoftohen nëpërmjet referencës në aplikim të nenit përkatës të statutit ose aktit të themelimit apo të dokumenteve shoqëruese të depozituara.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

### Neni 37

#### **Të dhënat për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja**

Për regjistrimin fillestar të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja janë të detyrueshme këto të dhëna:

a) të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 32 të këtij ligji për shoqëritë e huaja, përfshirë numrin dhe vendin e regjistrimit;

b) kapitalin e shoqërisë së huaj;

c) emrin e degës ose të zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj;

ç) kohëzgjatjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;

d) fushën e veprimtarisë së degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;

dh) selinë e degës ose të zyrës së përfaqësimit;

e) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;

ë) specimetet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët.

### Neni 38

#### **Të dhënat për shoqëritë dhe unionet e kursim-kredive**

Për regjistrimin e shoqërive dhe të unioneve të kursim-kredive, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, për shoqëritë tregtare janë të detyrueshme të njoftohen edhe lloji dhe vlera e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, fakti nëse kapitali i nënshkruar është i paguar, si dhe pjesa e paguar, të dhënat e identifikimit të anëtarëve të organit mbikëqyrës, ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre.

## **Neni 39**

### **Të dhënat për shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë**

Për regjistrimin e shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, për shoqëritë tregtare njoftohet edhe lloji dhe vlera e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, fakti nëse kapitali i nënshkruar është i paguar, si dhe pjesa e paguar, përcaktimi i territorit të veprimtarisë dhe të dhënat e identifikimit të anëtarëve të organit mbikëqyrës, të ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre.

## **Neni 40**

### **Subjektet e tjera**

Nëse një subjekt ka detyrimin e regjistrimit, sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, atëherë mënyra e aplikimit për regjistrimin fillestar dhe të dhënat e detyrueshme për t'u regjistruar nga këto subjekte, sipas seksionit IV, të këtij ligji, përcaktohen nga ligji i posaçëm.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## **Neni 41**

### **Pagesa e kapitalit**

Vërtetimi i shlyerjes së kapitalit themeltar nuk përbën kusht për regjistrimin fillestar në regjistrin tregtar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, me përjashtim të rastit kur në ligje të posaçme parashikohet ndryshe.

## **Neni 42**

### **Pasojat e regjistrimit fillestar**

1. Subjektet, që regjistrohen si persona juridikë, e fitojnë personalitetin juridik me regjistrimin në regjistrin tregtar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligje të posaçme.

2. Regjistrimi në regjistrin tregtar për personat fizikë, degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqëritë e thjeshta, sipas Kodit Civil dhe subjektet e tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk fitojnë personalitet juridik nëpërmjet këtij regjistrimi, ka vetëm efekt deklarativ.

## **SEKSIONI IV**

### **REGJISTRIMET E TJERA**

## **Neni 43**

### **Regjistrimet e tjera të detyrueshme**

1. Çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas seksionit III.

2. Në rast ndryshimi të aktit të themelimit, statutit ose ndryshimit të kontratës së shoqërisë së thjeshtë (kur është në formë të shkruar), depozitohet edhe teksti i plotë i tyre, që pasqyron ndryshimet e mëpasshme. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja depozitohet statuti dhe akti i themelimit të shoqërisë së huaj apo dokumenti ekuivalent i krijimit, sipas legjislacionit të huaj, me tekstin e plotë, që pasqyron ndryshimet e bëra.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

b) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar, në rastet kur emërimi është i detyrueshëm, numrin e licencës profesionale, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;

c) emërimin e likuiduesve, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;

ç) aktet e prishjes, mbylljes apo shpërndarjes, aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, ndarjes, hapjes dhe mbylljes së procedurave të likuidimit ose falimentimit të shoqërisë së huaj;

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

dh) dokumentet, që vërtetojnë vënien e pengjeve ose garancitë e tjera për pjesëmarrjet në kapitalin e subjektit;

e) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Pavarësisht nga sa më sipër, shoqëria **aksionare** nuk detyrohet të njoftojë çdo transferim të aksioneve. Shoqëria, së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, njofton listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## Neni 44

### Regjistrimet e tjera vullnetare

Subjektet mund të regjistrojnë çdo të dhënë tjetër, të ndryshme nga të dhënat e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e tyre ekonomike tregtare. Këto të dhëna shtesë përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë (nëse është/janë i/të ndryshëm nga emri i regjistruar i subjektit);

b) çdo transferim të aksioneve nominative për shoqëritë **aksionare** që, përveç personave të autorizuar, mund të regjistrohet edhe me aplikimin e çdo aksioneri të interesuar;

c) *web-site, e-mail, telefon dhe faks;*

ç) vendimet e organeve drejtuese të subjektit, si vendimet e pezullimit të veprimitarisë apo vendimet e tjera të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

d) të dhëna të tjera, të lidhura me veprimtari të subjektit.

#### **Neni 45**

### **Regjistrimet me vendim gjyqësor**

1. QKB-ja regjistron në regjistër dhe publikon, kryesisht ose me kërkesë nga çdo person i interesuar, vendimet gjyqësore për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e subjektit.

2. Kërkesës për regjistrime nga personat e interesuar i bashkëlidhet vendimi përkatës. Regjistrimi kryhet brenda afatit njëditor nga dita kur QKB-së i njoftohet vendimi përkatës ose nga data e paraqitjes së kërkesës së palës së interesuar.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

#### **Neni 46**

### **Regjistrimi i pasqrave financiare**

1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.

2. Nëse një subjekt nuk përmbush detyrimin, sipas këtij neni, atëherë QKB-ja, së bashku me zbatimin e sanksionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të këtij ligji, vepron në përputhje me parashikimet e shkronjës “ë”, të nenit 54, të këtij ligji.

Neni 47 shfuqizohet.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## **SEKSIONI V**

### **ÇREGJISTRIMI**

#### **Neni 48**

### **Çregjistrimi i subjektit**

1. Subjektet çregjistrohen nga regjistri tregtar në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridikë,

shpërndarjen e shoqërisë së thjeshtë, në rastet e përfundimit të ushtrimit të veprimtarisë të personit fizik, si dhe në çdo rast tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

2. Çregjistrimi bëhet:

- a) në mënyrë vullnetare nga subjekti;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) sipas parashikimit të ligjeve të posaçme.

## Neni 49

### Çregjistrimi vullnetar

1. Për personat fizikë dhe për subjektet e tjera, në rastet kur ligji nuk parashikon procedura likuidimi në lidhje me to, çregjistrimi në mënyrë vullnetare kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim.

Çregjistrimi në mënyrë vullnetare për personat juridikë, degët dhe zyrat përfaqësimit të shoqërive të huaja për shoqëritë e thjeshta dhe për subjektet e tjera, për të cilat ligji parashikon procedura likuidimi.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

2. kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim dhe depozitimit të akteve përkatëse, që vërtetojnë kryerjen dhe mbylljen e procedurave të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi. Çregjistrimi nuk kryhet nëse aktet e ndërmjetme të procesit të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi, nuk janë njoftuar dhe depozituar pranë regjistrit tregtar. Këto akte depozitohen në formën e kërkuar nga ky ligj dhe/ose nga dispozita të tjera ligjore në fuqi.

## Neni 50

### Çregjistrimi në rast vdekjeje

Në rast vdekjeje të personit fizik, çregjistrimi mund të kryhet me kërkesë të çdo pale të interesuar dhe me depozitim të dokumenteve përkatëse. Gjithashtu, çdo palë e interesuar mund të kërkojë çregjistrimin e personit fizik nga regjistri tregtar, duke depozituar vendimin e gjykatës, me të cilin një person është shpallur i vdekur.

## Neni 51

### Çregjistrimi me vendim gjyqësor

1. Subjekti mund të çregjistrohet në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që vendos se subjekti priset, mbaron apo nuk mund të ushtrojë më veprimtari.
2. QKB-ja çregjistron kryesisht subjektin në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, me anë të të cilit vendoset çregjistrimi i subjektit në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon procedura likuidimi për këto subjekte, ose në vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit apo të procedurave të tjera që mund të kërkojnë sipas ligjit.



(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## **Neni 52**

### **Të dhënat e subjekteve të çregjistruara**

1. Të dhënat e subjekteve të çregjistruara mbahen në regjistrin tregtar, duke vënë shënimin “i çregjistruar”, si dhe numrin e datën e vendimit gjyqësor ose të autoritetit tjetër publik, sipas ligjeve të posaçme, që ka vendosur çregjistrimin nga regjistri tregtar, ose në rastin e çregjistrimit vullnetar, të dhënat e aktit dhe të aplikimit, nëpërmjet të cilit është kryer çregjistrimi. Këto të dhëna ruhen nga QKB-ja në format elektronik dhe janë gjithnjë të aksesueshme për publikun.

2. Emri i subjektit do të vlerësohet i zënë dhe nuk mund të regjistrohet nga asnjë subjekt tjetër për një afat prej 6 muaj nga data e çregjistrimit.

## **Neni 53**

### **Pasojat e çregjistrimit**

1. Çregjistrimi i personave juridikë nga regjistri tregtar ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme.

2. Çregjistrimi nga regjistri tregtar i personave fizikë, degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqërive të thjeshta, sipas Kodit Civil, si dhe të subjekteve të tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm efekt deklarativ.

3. Subjektet e çregjistruara përgjigjen për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KREU IV**

### **VENDIMARRJA DHE PUBLIKIMI**

#### **SEKSIONI I**

### **SHQYRTIMI DHE VENDIMARRJA**

## **Neni 54**

### **Shqyrtimi i aplikimit**

1. QKB-ja asiston aplikantin në plotësimin e aplikimit dhe verifikon:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;

b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;

c) paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;

ç) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin;

d) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;

dh) nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet;

e) pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;

ë) faktin nëse aplikuesi ka shlyer sanksionet administrative të dhëna dhe ka kryer regjistrimet e kërkuara sipas nenit 46.

. (Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.).

2.QKB-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

3.QKB-ja lëshon një confirmim me shkrim, sipas një formati të miratuar, për çdo aplikim të dorëzuar.

4.Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë kohën e dorëzimit, numrin rendor të paraqitjes së aplikimit, objektin e aplikimit, listën e dokumenteve të dorëzuara dhe shumën e tarifës së paguar.

5.QKB-ja merr në shqyrtim aplikimet për regjistrim, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

6.QKB-ja është e detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse aplikimi është i paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta. Në çdo rast QKB-ja përgjigjet me shkrim.

## **Neni 55**

### **Pranimi i regjistrimit**

1. QKB-ja, pasi kryen verifikimet përkatëse, sipas nenit 54 të këtij ligji dhe vëren përmbushjen e kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin në regjistër dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një afati prej një dite nga data e paraqitjes së aplikimit.

2. QKB-ja nuk mund të refuzojë regjistrimin, nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve të këtij ligji.

## **Neni 56**

### **Pezullimi i aplikimit**

1. Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 54, të këtij ligji, rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit, ka sanksione administrative të papaguara apo nuk janë kryer regjistrimet e kërkuara, sipas nenit 46, QKB-ja pezullon aplikimin dhe e njofton aplikuesin me shkrim për shkakun e saktë të pezullimit, duke i dhënë një afat prej 21ditësh kalendarike për plotësimin ose

ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard të QKB-së.  
(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

2. Nëse aplikanti plotëson ose ndreq elementet që pengojnë regjistrimin, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, QKB-ja është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati 1-ditor nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit. Në këtë rast, regjistrimi mban datën e paraqitjes së aplikimit të parë.

### **Neni 57**

#### **Refuzimi i regjistrimit**

1. Regjistrimi refuzohet vetëm në rastet kur:
  - a) aplikimi nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe aplikanti nuk plotëson ose ndreq elementet, që pengojnë regjistrimin brenda afatit;
  - b) të dhënat, që kërkohen të regjistrohen, janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Refuzimi i njoftohet aplikantit me shkrim, sipas formularit standard, në të cilin jepet edhe shkakut të këtij refuzimi.
3. Riparaqitja e aplikimit pas refuzimit trajtohet si aplikim i ri.

### **Neni 58**

#### **Miratimi i heshtur**

1. Në rastin kur QKB-ja, brenda afatit njëditor, sipas neneve të mësipërme, nuk kryen regjistrimin, nuk njofton pezullimin e aplikimit apo nuk njofton refuzimin, atëherë aplikimi për regjistrim quhet i pranuar menjëherë.
2. QKB-ja detyrohet të kryejë publikimin e të dhënave të regjistruara.

## **SEKSIONI II**

### **REGJISTRIMI I NJËKOHSHËM, NUMRI UNIK I IDENTIFIKIMIT, PUBLIKIMI DHE LËSHIMI I CERTIFIKATAVE**

### **Neni 59**

#### **Regjistrimi i njëkohshëm**

Regjistrimi i subjekteve në regjistrin tregtar përbën, gjithashtu, regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë **administratës tatimore, qendrore dhe vendore,**  
(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

1. në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës.
2. Subjektet, për qëllimet e regjistrimit e të pajisjes me certifikatën e regjistrimit fillestar, deklarojnë, gjithashtu, të dhënat e detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor, të

sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave, sipas formularëve përkatës.

3. Me përjashtim të rasteve kur ligji shprehimisht kushtëzon nisjen e veprimtarisë përkatëse me marrjen e një lejeje, licence apo autorizimi, subjekti i pajisur nga QKB-ja me certifikatën e regjistrimit fillestar ka të drejtë të nisë menjëherë veprimtarinë e tij.

4. Me përjashtim të rasteve kur ligji shprehimisht kushtëzon nisjen e veprimtarisë përkatëse me marrjen e një lejeje, licence apo autorizimi, asnjë autoritet publik nuk mund ta pengojë subjektin të nisë veprimtarinë, menjëherë pasi është pajisur nga QKB-ja me certifikatën e regjistrimit fillestar dhe as ta penalizojë atë, në asnjë formë, për shkak të kërkesave për kryerjen paraprakisht të deklarimeve, regjistrimeve, certifikimeve apo të ndonjë veprimi tjetër, që mund të kërkohen, sipas praktikës administrative apo kuadrit ligjor. Autoriteti publik, që pengon nisjen e veprimtarisë së subjektit, sipas këtij neni, përgjigjet sipas ligjit për dëmin jashtë kontraktor të administratës publike.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## **Neni 60**

### **Numri unik i identifikimit të subjektit**

1. Me regjistrimin në regjistër, subjekteve u jepet numri i identifikimit, i cili gjenerohet në mënyrë elektronike nga QKB-ja dhe është unik për çdo subjekt të regjistruar.

2. Numri unik i identifikimit të subjektit është i vlefshëm për identifikimin e subjekteve, për qëllimet e regjistrimit në regjistër, për qëllimet e regjistrimit si person i tatueshëm pranë autoriteteve fiskale, qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues.

3. Numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit.

4. Subjektet e regjistruara janë të detyruara të shënojnë numrin unik të identifikimit të subjektit në çdo korrespondencë të tyre.

## **Neni 61**

### **Publikimi elektronik**

1. Çdo e dhënë e regjistruar në regjistër nga QKB-ja publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga QKB-ja në format elektronik dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit.

2. QKB-ja kryen publikimin në buletin brenda një dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data, në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar.

3. QKB-ja për çdo ditë pune publikon në buletin të gjitha regjistrimet e kryera gjatë ditës së mëparshme.

4. Publikimi në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit përbën publikim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 21 të këtij ligji.

5. Me vendim të ministrit mund të parashikohen botime të tjera ndihmëse për njoftimin e regjistrimeve. Në çdo rast, këto botime nuk cenojnë efektet e publikimit sipas pikave 1 deri në 3 të këtij neni.

## **Neni 62**

### **Çertifikatat e regjistrimit fillestar**

1. QKB-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj për regjistrimin fillestar, i lëshon subjektit të regjistruar certifikatën e regjistrimit, e cila përmban emrin, formën, numrin unik të identifikimit, datën e regjistrimit fillestar dhe selinë ose adresën e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë.

2. Në rast se subjekti i regjistruar ushtron veprimtarinë në më shumë se një vend, QKB-ja lëshon nga një certifikatë regjistrimi për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë, gjithashtu, emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe numrin unik të identifikimit të subjektit.

3. Në rastet kur subjekti ndryshon emrin, formën, selinë apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, QKB-ja zëvendëson certifikatat e lëshuara më parë me një certifikatë të re për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë, gjithashtu, emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe numrin unik të identifikimit të subjektit.

4. Certifikata e regjistrimit lëshohet në një kopje origjinale për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Në rast humbjeje apo dëmtimi të certifikatës së regjistrimit, ajo zëvendësohet me një dublikatë të lëshuar nga QKB-ja.

5. Subjekti detyrohet të afishojë certifikatën përkatëse në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë.

## **Neni 63**

### **Vërtetime për regjistrimet**

Pas regjistrimit, sipas dispozitave të këtij ligji, QKB-ja i lëshon subjektit një vërtetim regjistrimi, ku përcaktohen qartë veprimi i kryer dhe data e këtij regjistrimi.

## **Neni 64**

### **Formati dhe përmbajtja**

Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton formatin dhe përmbajtjen e certifikatave, vërtetimeve dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, sipas këtij ligji.

## **Neni 65**

### **Korrigjimi i gabimeve**

1. Pasaktësitë, gabimet e shtypit ose gabimet e tjera të dukshme të këtij lloji, të bëra gjatë regjistrimeve, të cilat rezultojnë qartë nga dokumentacioni i depozituar dhe nuk cenojnë vlefshmërinë e regjistrimit, mund të korrigjohen nga QKB-ja kryesisht apo me kërkesë të personave të interesuar.

2. Ndryshimi i të dhënave të pasakta, të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një aplikimi të ri apo në bazë të një vendimi gjyqësor.

3. Ndreqja e pasaktësive apo gabimeve publikohet, sipas dispozitave të nenit 61 të këtij ligji.

4. Aplikimi për ndreqje të gabimeve kryhet pa pagesë.

## KREU V

### AKSESI PUBLIK DHE EKSTRAKTET

#### Neni 66

#### Kërkimet në bazën e të dhënave

Çdo person i interesuar mund të kryejë, sipas këtij ligji, pa pagesë, pranë çdo sporteli shërbimi, kërkime në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve.

#### Neni 67

#### Ekstraktet e regjistrit

1. QKB-ja konfirmon të dhënat e regjistruara nga subjektet, sipas këtij ligji, nëpërmjet lëshimit të ekstrakteve në format shkresor apo elektronik, sipas këtij ligji. Çdo person, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, ka të drejtë të marrë pa pengesa, në format shkresor apo elektronik, sipas dëshirës, ekstrakte për të dhënat e regjistruara të çdo subjekti, si dhe kopje të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistër.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

2. Ekstraktet mund të lëshohen për të dhëna të caktuara të subjekteve dhe/ose për historikun e veprimeve të kryera nga një subjekt.

3. Të dhënat për adresën e banimit të individëve, sipas pikës 1 të nenit 66 të këtij ligji, janë të aksesueshme nga çdo person i interesuar, vetëm në bazë të një kërkesë, ku shënohet identiteti i kërkuesit.

4. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton formatin e ekstrakteve dhe të kërkesës për lëshimin tyre.

#### Neni 68

#### Vërtetimi i ekstrakteve dhe i dokumenteve shoqëruese

1. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format shkresor, si rregull, lëshohen nga QKB-ja, si kopje e vërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar heq dorë nga marrja e këtij vërtetimi.

2. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format elektronik, si rregull, lëshohen nga QKB-ja si kopje e pavërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar shprehimisht kërkon ta marrë këtë vërtetim.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## **Neni 69**

### **Komunikimi elektronik me autoritete të tjera publike**

QKB-ja, për të garantuar lehtësimin e procedurave të regjistrimit dhe ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë, në favor të subjekteve të interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bashkëpunon me autoritete të tjera publike dhe mundëson ndërlidhjen dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave, të regjistruara në bazën e saj elektronike, me regjistra apo baza të dhënash elektronike të autoriteteve të tjera publike, si brenda, ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 70**

### **Veprimet pranë sportelit elektronik**

1. Çdo individ, pasi të jetë identifikuar elektronikisht, ka të drejtë që, në cilësinë e aplikantit apo të personit të autorizuar, të aplikojë apo të kryejë pranë sportelit elektronik çdo regjistrim apo veprim tjetër, sipas këtij ligji, përfshirë këtu procedurat e ankimit administrativ, dhe të marrë nga QKB-ja nëpërmjet këtij sporteli të gjitha aktet përkatëse të parashikuara nga ky ligj.

2. Çdo individ, pa qenë i detyruar të identifikohet elektronikisht, ka të drejtë të kryejë pranë sportelit elektronik kërtime elektronike në regjistër, të marrë ekstrakte, si dhe kopje të dokumenteve shoqërues në format elektronik apo të kryejë veprime të tjera, për të cilat identifikimi i personit, kryerja e pagesës së një tarife nëpërmjet mjeteve elektronike, nuk kërkohet sipas këtij ligji.

## **Neni 70/1**

### **Identifikimi elektronik**

Veprimet pranë sportelit elektronik të QKB-së, për të cilat ky ligj kërkon identifikimin elektronik, kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

## **Neni 70/2**

### **Kushtet procedurale dhe teknike**

Ministri përcakton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin shërbimeve nga QKB-ja, sipas këtij ligji, nëpërmjet sportelit elektronik, kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat për ndryshimin e tyre, kushtet e sigurisë dhe të ruajtjes së komunikimeve elektronike, mënyrat e vërtetimit të dokumenteve elektronike, të lëshuara nga QKB-ja, të kërkesave e teknologjisë së zbatueshme për realizimin e tyre, sipas këtij kreu, si dhe procedurat e njoftimit publike, të realizuara nga QKB-ja për



rastet e remonteve të planifikuara apo të incidenteve teknike të sportelit elektronik, si dhe për njoftimin e rasteve të ndërhyrjeve të paautorizuara.  
(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## KREU VII

### ANKIMI DHE KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

#### Neni 71

##### Ankimi administrativ

1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj veprimeve apo mosveprimeve të QKB-së për regjistrimet dhe publikimet, sipas dispozitave të këtij ligji. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftimin për pranimin apo refuzimin e regjistrimit, sipas këtij ligji, ose nga data kur regjistrimi është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit.

2. Në rastet kur ky ligj parashikon miratimin e heshtur dhe QKB-ja nuk lëshon certifikatat apo nuk kryen publikimet përkatëse brenda afatit të parashikuar, subjekti ka të drejtë të ankohet, në çdo kohë, në rrugë administrative, duke kërkuar lëshimin e certifikatës së regjistrimit fillestar apo të certifikatës, që vërteton regjistrimet e tjera të kryera, si dhe publikimin e këtyre të dhënave sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative kur QKB-ja nuk lëshon ekstraktet apo kopjet e vërtetuara të akteve, sipas dispozitave të këtij ligji. Afati 30-ditor për paraqitjen e ankimit fillon pas 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës për lëshimin e ekstraktit apo kopjes së aktit të kërkuar.

#### Neni 72

##### Organi kompetent për ankimin

1. Ankimi administrativ, sipas nenit 71 të këtij ligji, i drejtohet titullarit të QKB-së dhe paraqitet, sipas formave e procedurave të përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative, në selinë qendrore të QKB-së ose në çdo sportel shërbimi të saj.

2. Titullari i QKB-së shqyrton ankimin, merr vendim dhe ia njofton palës së interesuar brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Ndaj aktit të titullarit të QKB-së apo mosveprimit të tij mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatë, sipas legjislacionit që rregullon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

#### Neni 73

##### Përgjegjësia jashtëkontraktore

QKB-ja, në përputhje me ligjin për dëmin jashtëkontraktor të administratës publike, përgjigjet për dëmet e shkaktuara nga mosveprimi ose nga veprimi në kundërshtim me ligjin.

#### **Neni 74**

##### **Kundërvajtjet administrative**

1. Subjekti përgjigjet, sipas ligjeve në fuqi, për vërtetësinë e fakteve, të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistër.

2. Deklarimi në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

3. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

4. Gjoha vendoset nga titullari i QKB-së, vendimi i të cilit ankimohet drejtpërdrejt në gjykatën administrative..

( Pika 5 shfuqizohet.)

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

### **KREU VIII**

#### **DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT**

#### **Neni 75**

##### **Procedurat e regjistrimit të subjekteve ekzistuese**

1. Regjistri i shoqërive tregtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistri i personave fizikë tregtarë pranë gjykatave përkatëse të rretheve, regjistri i shoqërive dhe i unioneve të kursim-kreditit, regjistri i shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, transferohen në administrim të QKB-së në format material dhe elektronik brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Organet tatimore, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i japin QKB-së të gjitha të dhënat, që ato kanë për subjektet e regjistruara në regjistrat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për aq sa ato janë të domosdoshme për të shënuar numrin unik të identifikimit të subjektit.

3. Të gjitha të dhënat e regjistrave dhe dokumentet shoqëruese, që transferohen pranë QKB-së, regjistrohen dhe publikohen, kryesisht, nga QKB-ja pa pagesë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

4. Të gjitha subjektet dhe regjistrimet përkatëse në këta regjistra vlerësohen automatikisht të reregjistruara në regjistrin tregtar, që nga data e regjistrimit të parë.

5. Në qoftë se nga procesi i reregjistrimit evidentohen subjekte me emra të njëjtë ose të ngjashëm, QKB-ja publikon, në një seksion të veçantë të faqes zyrtare të internetit, një listë të plotë të këtyre subjekteve, duke saktësuar datat e regjistrimit të secilit në gjykatë.

6. Subjektet, që janë regjistruar më parë në regjistrat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe nuk kanë kryer regjistrim tek organet tatimore, publikohen në një seksion

të veçantë të faqes së internetit të QKB-së. Në rast se këto subjekte nuk njoftojnë fillimin e veprimtarisë tregtare brenda një afati prej 6 muajsh nga data e këtij publikimi, QKB-ja kryen kryesisht çregjistrimin e tyre nga regjistri.

Subjektet që, megjithëse kanë kryer regjistrimin pranë organeve tatimore, kanë regjistrime të pasakta apo të paplota, publikohen në një seksion të veçantë të faqes së internetit të QKB-së, duke përcaktuar të dhënat e pasakta apo të paplota, si dhe veprimin që duhet të ndërmerret apo dokumentin shoqërues që duhet të depozitohet. Gjykatat përkatëse vazhdojnë të pranojnë kërkesa për kryerjen e veprimeve të regjistrimit deri në datën e fillimit të regjistrimeve nga QKB-ja, sipas afateve të parashikuara në pikën 2 të nenit 77 të këtij ligji. (SHFUQIZOHET FJALIA E DYTE)

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

7. Ankimet ndaj regjistrimeve të kryera nga gjykatat deri në afatin e parashikuar në pikën 8 të këtij neni, shqyrtohen sipas procedurës së parashikuar nga ligji i mëparshëm.

8. Ministri i Drejtësisë dhe ministri që mbulon çështjet e tregtisë ngarkohen të përcaktojnë me urdhër të përbashkët procedurën e transferimit pranë QKB-së të regjistrave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

9. Në rastet e parashikuara në pikën 7 të këtij neni, subjekti hiqet nga statusi pasiv me njoftimin, saktësimin e regjistrimit ose me depozitim të dokumenteve shoqëruese. Në këto raste nuk aplikohet sanksion administrativ.

(PIKA 11 SHFUQIZOHET)

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## Neni 76

### Aktet nënligjore në zbatim të ligjit

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë procedurat e hollësishme të shqyrtimit, miratimit, pezullimit, refuzimit të aplikimit dhe publikimit për regjistrim fillestar, për regjistrimet e tjera dhe çregjistrimin e subjekteve, si dhe procedurën e hollësishme të ndreqjes së gabimeve në regjistrim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë procedurat e hollësishme për deklarimin, trajtimin dhe shkëmbimin e të dhënave të detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të punës dhe atij të statistikave, sipas nenit 59 të këtij ligji, si dhe të miratojë procedurën e lëshimit të numrit unik të identifikimit të subjektit.

3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, përcakton formën dhe përmbajtjen e dokumenteve që lëshohen nga QKB-ja dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer.

4. Ngarkohet ministri të miratojë procedurat e hollësishme për mbrojtjen dhe sigurinë e bazës të së dhënave elektronike të regjistrimit.

5. Këshilli i Ministrave dhe ministrat e ngarkuar sipas këtij ligji për nxjerrjen e akteve nënligjore të plotësojnë këtë detyrim brenda një afati prej 2 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 77 shfuqizohet

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## Neni 78

### Ndryshime dhe shfuqizime

1. Në çdo ligj ose akt nënligjor në fuqi, ku përmendet emri gjykatë, për qëllime të regjistrimit të subjekteve të këtij ligji, do të zëvendësohet me QKB-ja.
2. Ligji nr. 7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

### Dispozita të fundit dhe kalimtare

Çdo parashikim ligjor e nënligjor, që bie në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, siç është ndryshuar nga neni 30, i këtij ligji, shfuqizohet.

(Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

## Neni 79

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Shpallur me dekretin nr.5740, datë 26.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 27.9.2012. Shpallur me dekretin nr.7793, datë 15.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.02.2015.

Shpallur me dekretin nr. 8990, datë 6.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

K R Y E T A R E  
Jozefina Topalli (Çoba)

### Hyrja në fuqi

1. Ky ligj, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.11.2015 Shpallur me dekretin nr. 9339, datë 4.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

Ndryshuar me Ligj, Nr.9916, datë. 12.05.2008, botuar në Fletoren .Zyrtare Nr.76, datë 5 korrik 2012.

Ndryshuar me Ligj, Nr.92/2012, datë:27.09.2012, botuar në Fletoren .Zyrtare Nr.135,datë 17 tetor 2012.

Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, datë 19.02.2015, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.32, datë 9 mars 2015.

Ndryshuar me Ligj, Nr.131/2015, datë 26.11.2015, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.205, datë 1 dhjetor 2015.